



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

**DRAFT-RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE
SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATEN
KOMUNALE**

P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Draft-rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në administratën komunale mbajtur më: **15.05.2025**, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora **11:00**.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit
6. Fisnik Shoshaj, Zyra e Personelit;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Fisnik Shoshaj, Udhëheqës i Zyrës së Personelit.

Udhëheqësi, z. Fisnik Shoshaj – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Draft-rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në administratën komunale dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Draft-rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në administratën komunale,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Konsultimi publik u mbajt për të diskutuar Draft-Aktin për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Istogut. Takimi kishte për qëllim informimin e publikut dhe marrjen e komenteve lidhur me strukturën organizative të administratës komunale.

Takimi u hap nga përfaqësuesi i burimeve njerëzore, i cili shpjegoi ndryshimet e propozuara dhe arsyet e rishikimit të strukturës ekzistuese. U theksua se akti synon rritjen e efikasitetit, qartësimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Gjatë diskutimit u shpjeguan pozitat e reja të propozuara, riorganizimi i disa njësive dhe përmirësimi i përshkrimeve të vendeve të punës. U theksua rëndësia e profesionalizmit dhe ndërtimit të një administrate funksionale.

Pjesëmarrësit dhanë komente lidhur me ngarkesën e punës, nevojën për trajnime dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit. U kërkua që procesi të jetë transparent dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përfundim, u theksua se të gjitha komentet do të dokumentohen dhe do të shqyrtohen para miratimit final të aktit.

Faleminderit shumë!

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

